



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 23 datë 10.5.2022

**“PËR MIRATIMIN E MASËS SË QIRASË MUJORE PËR BANESAT SOCIALE
ME QIRA PRANË ISH-KONVIKTIT TË SHKOLLËS VETERINARE TË
BASHKISË SHKODËR”.**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 10.05.2022, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 24 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; nenit 30 pika 2 e ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”; pika 7 dhe 8 e VKM nr.522, datë 25.07.2019 “Metodika e llogaritjes së masës së qirasë për banesat sociale me qira”; si dhe relacionin e përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër:

V E N D O S I:

1. Miratimin e masës së qirasë mujore për banesat sociale me qira pranë ish-konviktit të shkollës Veterinare Bashkia Shkodër si më poshtë:

Qiraja mujore e apartamentit A 1+1 me sipërfaqe 33 m² = **4,279 Lekë/Muaj.**

Qiraja mujore e apartamentit B 1+1 me sipërfaqe 37 m² = **4,729 Lekë/Muaj.**

Qiraja mujore e apartamentit C 2+1 me sipërfaqe 55 m² = **7,206 Lekë/Muaj.**

Qiraja mujore e apartamentit D 2+1 me sipërfaqe 62 m² = **8,107 Lekë/Muaj.**

Bashkëlidhur, shtojca A.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

KRYETAR

Brisela KADISA



Sekretari i Këshillit Bashkiak


Denis Lesha

Miratuar me 28 vota

Vota Pro 28

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 12.5.2022

Shtojca A: Metodika e Llogaritjes së Masës së Qirasë Për Banesat Sociale me Qira:

Përcaktimi i qirasë mujore për Banesat sociale tek ish-konvikti i shkollës veterinare sipas pikës 7 dhe 8 të VKM Nr. 522, Datë 25.07.2019 “Metodika e llogaritjes së masës së qirasë për banesat sociale me qira” është si më poshtë:

Sipas pikës 7 të VKM Nr.522, Datë 25.07.2019 kostoja totale e ndërhyrjes/investimit për përshtatjen në banesë sociale referuar çertifikatës së përkohshme të marrjes në dorëzim të punimeve me datë 18.02.2022 dhe kërkesës për rregjistrimin e pasurisë me datë 26.02.2016, bashkëlidhur është :

Vlera e rikonstruksionit	90,076,308 Lekë
Tarifa për rregjistrimin e pasurisë	4,200 Lekë
Kostoja totale e objektit	90,080,508 Lekë

Kosto Totale e objektit = 90,080,508 Lekë

Sipas planimetrisë së objektit kemi 4 grupe apartamentesh:

1. 8 apartamente 1+1 me sipërfaqe 33 m².
2. 4 apartamente 1+1 me sipërfaqe 37 m².
3. 4 apartamente 2+1 me sipërfaqe 55 m².
4. 12 apartamente 2+1 me sipërfaqe 62 m².

K_{totale} = 90,080,508 Lekë

QV total = 90,080,508 x 3% = 2,702,415 Lekë

QM total = 2,702,415 Lekë / 12 = 225,201 Lekë/Muaj

S_{banimit} = 1710 m²

S_A = 33 m² P_A = 33/1710 = 0.019 = 1.9 %

Q_m = 1.9 % x 225,201 = 4,279 Lekë/Muaj

S_B = 37 m² P_B = 37/1710 = 0.021 = 2.1%

Q_m = 2.1 % x 225,201 = 4,729 Lekë/Muaj

S_C = 55 m² P_C = 55/1710 = 0.032 = 3.2 %

Q_m = 3.2 % x 225,201 = 7,206 Lekë/Muaj

S_D = 62 m² P_D = 62/1710 = 0.036 = 3.6 %

$$Q_m = 3.6 \% \times 225,201 = 8,107 \text{ Lekë/Muaj}$$

Shkurtime:

K. Total = Kostoja totale për të gjithë objektin.

QV_{total} = Qiraja vjetore për të gjithë objektin. (K x 3%)

QM_{total} = Qiraja mujore për të gjithë objektin. (QV_{total} / 12)

S = Sipërfaqja e përgjithshme e banimit.

S_A = Sipërfaqja e një apartamentit tip.

P = Përqindja që zë sipërfaqja e apartamentit ndaj totalit. (S_A / S)

QM_A = Qiraja mujore e apartamentit tip.

